



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 12.09.2022

Për: Burim Bajrami, Udhëheqës i sektorit për punë të Kuvendit të Komunës së Gjakovës

Lënda: Përgjigje në kërkesë

I nderuar z. Bajrami,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka pranuar një kërkesë nga ju, lidhur me shqyrtimin e lidhshmërinë së vendimit Nr. 011/01-12331 të datës 28.07.2022 për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërimin e rrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës, i miratuar nga Kuvendi të Komunës së Gjakovës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën I, pika 9 të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të kërkesës sqaron se:


- Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL e ka dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë vendimin Nr. 011/01-12331 të datës 28.07.2022 për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërimin e rrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës, në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Në raportin e vlerësimit të ligjshmërisë MMPHI, ka konstatuar se aktit të lartshënuar i mungon baza ligjore për nxjerrjen e tij.
- Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Gjakovës duhet të ndërmarrin veprime konkrete që, vendimi Nr.011/01-12331, i datës 28.07.2022, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës, të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi brenda tridhjetë (30) ditëve. MAPL, mbetet në dispozicion të Komunës së Gjakovës për sqarime shtesë lidhur me bazën ligjore të aktit.

MAPL, është e gatshme të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt

Venera Çerkini,
Zv. Sekretare e Përgjithshëm e MAPL-së

Kopje: Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Arbëresha Kuqi, Kryesuese e Kuvendi të Komunës së Gjakovës
Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së
Arkiviti të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 12.09.2022.

Za: Burim Bajrami, rukovodilac Odseka za poslove u Skupštini opštine Đakovica

Predmet: Odgovor na zahtev

Poštovani g-ne. Bajrami,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS), primilo je vaš zahtev u vezi sa razmatranjem zakonitosti Odluke br. 011/01-12331 od dana, 28.07.2022 o formiranju komisije za razmatranje zahteva i žalbi za imenovanje puteva na teritoriji opštine Đakovica.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS), u skladu sa svojim mandatom utvrđenim Zakonom br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi prilogom (I), tačka 9, Uredbe VRK-a br. 02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, nakon razmatranja zahteva pojašnjava da:

- Na osnovu člana 7, Uredbe VRK o administrativnom razmatranju opštinskih akata, MALS je poslalo na razmatranje zakonitosti Odluku br. 011/01-12331 od 28.07.2022.godine za formiranje komisije za razmatranje zahteva i žalbi za imenovanje puteva na teritoriji opštine Đakovica, u Ministarstvu životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture (MSPPI). U izveštaju o proceni zakonitosti MSPPI-a je konstatovano da pomenuti akt nema pravni osnov za njegovo donošenje.
- Skupština opštine i gradonačelnik opštine Đakovica moraju da preduzmu konkretne delatnostie kako bi Odluka br. 011/01-12331, od dana 28.07.2022. godine, usvojena od strane Skupštine opštine Đakovica, bila usklađena sa zakonskim odredbama na snazi u roku od trideset (30) dana. MALS ostaje na raspolaganju Opštini Đakovica za dodatna pojašnjenja u pogledu pravnog osnova akta.

MALS, je spreman da pruži potrebnu podršku i pomoć za potpuno sprovođenje obaveza koje proizilaze iz primenjivog zakonodavstva na snazi o lokalnoj samoupravi u Republici Kosovo.

S poštovanjem,

Venera Çerkini,
zamenica generalnog sekretara MALS-a

Kopija: Ardian Gjini, gradonačelnik opštine Đakovica,
Arbëresha Kuqi, predsedavajuća Skupštine opštine Đakovica,
Elbert Krasniqi, ministar MALS-a,
Arhivi MALS-a.

From: Burim Bajrami
Sent: Tuesday, August 16, 2022 11:40 AM
To: Xhevat Tafa
Cc: Arbënesha Kuqi; Ardian Gjini
Subject: kërkesë për Konsultim

I Nderuar , z. Tafa !

Komuna e Gjakovës e ka pranuar një vlerësim të ligjshmërisë nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr.112/02 -19351/2022, për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave për emërtimin rrugëve , kërkesa dhe ankesa që kanë ardhur në vazhdimësi nga qytetarët e komunës së Gjakovës që nga përmbyllja e procesit të emërimit të rrugëve në Komunën e Gjakovës andaj ky komisioni është themeluar për me i dërgua në Kuvend propozimin për riemërtime apo përmasime në emërtimin e rrugëve pra me i lehtësua punën Kuvendit që ka në përbërja anëtar të Kuvendit dhe përfaqësues të drejtorive Komunale .

Në shkresën e pranuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kanë konstatuar se Mungon Baza Ligjore për nxjerrjen e këtij vendimi .


Baza ligjore i është shënuar dhe është e saktë duke u Bazuar në nenin 12 dhe 40.2 shkronja i të Ligjit nr. 03/L040 për vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 18.2 shkronja i të Statutit të Komunës së Gjakovës.

Në shkresën e Ministrisë kur ju ka referuar këtij vendimi numri i Protokollit të vendimit është shënuar gabim 01 nr.112/02 -12331 që është çështje teknike por që është gabim i ministrisë Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duhet të jetë 01 nr.112/02 -19351/2022 .

Kërkojmë sqarime nëse keni mundësi lidhur me këtë vlerësim si me veprua lidhur me këtë vlerësim nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për këtë vendim i cili e ka thirrjen dhe bazën e Plotë Ligjore gjithashtu në pikat 3 dhe 4 të vendimit janë të sqaruar se propozimi kalon në Kuvend për shqyrtim dhe vendosje në harmoni të Plotë me nenin 7 dhe 10 të ligjit Nr.04/L-071 për Sistemimin e Adresave .

Me respekt !

Burim Bajrami
Udhëheqës i Sektorit për punë të Kuvendit Komunal
Komuna e Gjakovës
Tel. 03820044068
Mob. 044637580



Republika e Kosovës - Republika Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA
Data/Datum: 01.08.2022
Kuvendi i Komunes - Gjakovë
01 Nr. /2022
Datë: 28.07.2022



Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit, 12 dhe 40.2 shkronja i të Ligjit nr. 03/L040 për vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 18.2 shkronja i të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.07.2022, pas diskutimit lidhur me pikën e 14 të rendit të ditës: Formimi i Komisionit për emërtimin e rrugëve në Komunën e Gjakovës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për Emërtimin e Rrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës me këtë përbërje:

1. Znj. Arbënesha Kuqi, Kryesues e Kuvendit .
2. Z. Him Zeqa , përfaqësues i Kuvendit
3. Znj. Ermira Mehmeti, Përfaqësuese e Kuvendit
4. Z. Ngadhnjim Dana, Përfaqësues i Kuvendit
5. Z. Labehat Sadrija , Përfaqësues i Kuvendit
6. Z. Nexhdet Morina, përfaqësues i Kuvendit
7. Znj. Krenare Bushaj, përfaqësuese e Kuvendit
8. Znj. Eranda Kumnova , përfaqësuese e Ekzekutivit të komunës.
9. Z. Rozafat Hoxha , Përfaqësues i DUMM-së .

2. Ky Komision në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale, duhet të veprojë në harmoni me dispozitat e Ligjit për Sistemin e Adresave, dhe të përgjigjet në ankesat dhe kërkesat e drejtuara për emërtimin e rrugëve në Komunën e Gjakovës .

4. Pas përfundimit të punës së këtij komisioni lista me emërtimet e propozuara të paraqiten në Kuvend për shqyrtim dhe miratim .

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

6. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Anëtarëve të Komisionit
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS	
MINISTRIE E LINDIMIT, SHËNIMIT DHE INFRASHTRUKTURËS	
MINISTRIE E LINDIMIT, SHËNIMIT DHE INFRASHTRUKTURËS	
Ndërkohë Organizimi Dokumenti Në Fjalë Bashkëpunimi Në Fjalë	Në Fjalë Dokumenti Në Fjalë Dokumenti Në Fjalë Dokumenti
106	43973/22
04	15.08.22
PRISHTINE / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Për:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPH Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për vlerësimin ligjor Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të 2. Zyrtari hartues i Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit vlerësimin ligjor Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.01-011/01-12331 për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërimin e rrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës, miratuar nga KK Gjakovë.

I nderuari Kryetar, Gjini,
E nderuara Kryesuese, Kuqi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 03.08.2022, ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr.01-011/01-12331 për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërimin e rrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës, miratuar datë 29.07.2022 nga KK Gjakovë.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të vendimit Nr.01-011/01-12331 për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërimin e rrugëve në territorin e Komunës së Gjakovës, miratuar nga KK Gjakovë, konstatoi se i njëjti nuk përmban bazën ligjore nga ku i buron e drejta e nxjerrjes së këtij vendimi.

Gjithashtu, konstatoam se formimi i këtij komisioni nuk parashihet me Ligjin Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave dhe aktet nënligjore që rrjedhin nga ky ligj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administacije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Servet Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MMPHI	
Kopje:	Ardian Gjini, Kryetari i Komunës së Gjakovës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme në MAPL	Datë: 02.08.2022 Nr.020-678
Nga:	Besim Murtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Kujtim Aliu, Zyrtar i Lartë Ligjor	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gjakovës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, Vendimin nr. 01-011/01-12331 për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërimin e rrugëve në territorin e komunës së Gjakovës, të datës 28.07.2022 i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin nr. 01-011/01-12331 për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërimin e rrugëve në territorin e komunës së Gjakovës
I miratuar më datë: 28.07.2022.

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.08.2022